

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: *BLERJE MATERIALE ELEKTRIKE PER NEVOJAT E BASHKISE RROGOZHINE*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 31681410-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 5.000.000 (pesë milion) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Rrogozhinë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9. Te kete te perfshire ne objektin e veprimtarise se shoqerise (QKB) tregtimin e mallrave objekt te kesaj kontrate.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit

limit qe prokurohet. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

2.2.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023,2024,2025** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilitetit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të ketë raport negativ, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ky kriter është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në bazë të pikës 3, të nenit 76, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe neni 43, pika 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjin nr. 9632 date 30.10.2006 “ Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a,b,c dhe neni 40, i Ligjit nr.

1131/2015 “Per QKB”, i ndryshuar si dhe Ligjin nr. 9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Furnizime te se njejtës natyre ne nje vlere **20% te fondit limit**, qe prokurohet te realizuara ne 3 (tre) vitet e fundit. Kjo do te vertetohet me dokumentat e meposhtme:

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) **Për përvojën e mëparshme të realizuar në sektorin publik:** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) **Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat:** operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te disponoje certifikatat e meposhtme ne lidhje me mallrat objekt prokurimi te vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave:

- Certificate e menaxhimit te cilesise ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga organizma Nderkombetare Akreditues, te njohur nga Republiken e Shqiperise. Ne rast Bashkim Operatoresh cdo anetar I grupit duhet te paraqese certifikaten ISO 9001:2015: ose ekuivalente.

Argumentimi: Kerkesat e cilesise jane kerkuar ne mbeshtetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 79, pika 1, ku percaktohet se “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 44, pika 1 dhe pika 3.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër të bëjë dorëzimin e mallit në magazinën e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pikë 9, të VKM-se nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.